REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI I SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 302,312/20
Datë/Datum 29.05.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj	**21.05.2019**	**29.05.2020**	**Nr.302/20** **Nr.312/20**
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 15.05.2020, OE "**Area SH.P.K**"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me **nr.302/20**, po asht me datën 20.05.2020, OE **"Rexha & Konti-Beton & Deshishku GB"** ka parashtruar ankesë me **nr,312/20** kundër vendimit për **dhënien** të aktivitetit te prokurimit **"Rregullimi i shtratit dhe zonave të degraduara të lumit Desivojcë-Komuna e Kamenicës"** me nr. prok. KM653-19-7914-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues **Komuna e Kamenicë.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: **punë**, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **700.000,00 €.**

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Nr.971/19.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE nga OE "Area" SHPK

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi
- Neni 7 i LPP-së- Barazia në trajtim/jo Diskriminimi
- Neni 59 i LPP-së- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 i LPP-së- Kritertet për dhënien e kontratës
- Vendimi i OSHP-së nr.971/19

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/**nuk** janë te njëjta.

Përkunder vendimit të OSHP-së nr. 971/19 dhe këthimit të lëndës në rivlerësim, AK nuk ka respektuar afatet ligjore dhe ka mbajtur në sirtar të vet lendën e dosjes së tenderit të cilat kanë qenë pa validitet dhe pa sigurim të tenderit, duke pasur parasyshë se nga data e hapjes së tenderit e deri në kërkesën e AK-së 21.04.2020 kur ka bërë kërkesën për OE konkurrues për vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të tenderit, kanë kaluar plotë 47 ditë që dokumentacioni dhe çmimet e ofruara nga OE konkurrues kanë qenë të pa afatshme, duke përfshirë edhe kompaninë e shpallur fitues, OE "Arbor Group & Euro via" SHPK (baza ligjore në të cilën është thirrë AK për arsyetimin e sqarimit 11.03.20320 është vetëm parafrazim abstrakt ligji i buxhetit dhe ligji i fondeve publike të cilat nuk kanë asnjë arsye të zbatimit procedural dhe material karshi legjislacionit të prokurimit publik.

Vendimi i AK-së pas kërkesës për rishqyrtim ka ardhë për qëllime favorizuese që për dhënicë te kontratës ta mbajë të drejtuar te OE "Arbor Group & Euro vita" SHPK. Pra në raastin konkret zyrtari përgjegjës i prokurimi i ndikuar nga ndonjë interes i caktuar ka tejkaluar kufijë e autorizimeve që posedon duke vepruar në

kundërshtim me kërkesat procedurale qënsore të legjislacionit në fuçi (duke rifilluar një proces të rivlerësimit pa afate ligjore).

Pretendimi nr.2
Me datën 05.05.2020 sipas vendimit të AK-së nuk janë plotësuar kërkesat e FDT pika 9.1&9.2 pika 2. Lista e Projekteve, kontratat e përfunduara dhe kontratat që janë në ekzekutim (duke mos përfillur nenin 7 par 1,2 dhe 4 i LPP-së, lidhur me parimet bazike nga nenin 4.4 i RRUOPP.
Pra AK nuk i pranon certifikatat e punëve që janë ekzekutuar dhe të pranuara nga institucionet e Kosovës, në këtë rast nga MAP-i si donator për projektin që është në ekzekutim me titullin "Ndërtimi i shkollës fillore në pozharan" vlera e punimeve të pranuara është 636.304,05 posedon çertifikatën e pranimit të punëve në bazë të kërkesave të kontratës saksisht neni 24 përfundimet dhe certifikatat e pranimit të punëve dhe nenit 25 llogaritja përfundimtare. Pjesa e II e kontratës kushtet e përgjithshme.
OSHP të merr vendim me të cilin:

I. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "Area" SHPK
II. Lënda të kthehet në Rivlerësim sipas vendimit të parë të OSHP-së nr.971/19

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE nga OE "Rexha & Konti-Beton & Deshishku GB " SHPK

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).
- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi
- Neni 6 i LPP-së – Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7 i LPP-së- Barazia në trajtim/jo Diskriminimi
- Neni 10 i LPP-së – Mjetet per promovimin e transparences
- Neni 11 I LPP-së – Informatat sekrete afariste
- Neni 56 I LPP-së - Dispozitat e Pergjithshme mbi Perzgjedhjen e Pjesemarresve dhe Dhenien e Kontratave
- Neni 59 i LPP-së- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 69 i LPP-së- Aftesia Teknike dhelose Profesionale

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.
Pretendimi Nr.1
Me kete pretendim e kemi kundershtuar si te pabaze arsyetimin e AK-se qe eshte dhene per eliminimin e parashtruesit te kerkeses me arsyetimin se gjoja nuk kemi vazhduar validitetin dhe sigurimin e tenderit. Eshte e vertete se grupi i OE ankues nuk e ka vazhduar validitetin e sigurimit te tenderit sic eshte kerkuar me shkrim nga AK me shkakun e situates se krijuar nga pandemia COVIT -19 ku procesi i vleresimit nuk ka mundur qe te finalizohet brenda afatit te periudhes se validitetit te tenderëve.
Perkunder se parashtruesi e ka pranuar kerkesen e AK-se per zgjatje te validitetit te sigurimit te teuderit te tyre, nuk do te thote se nuk kerni clashur qe ta vazhdojme validitetin mirepo duke pasur parasysh siruaten e papritur te krijuar nga pandemia COVIT -19 kemi konsideruar se nuk eshte relevante ne kete situate zgjatja e validitetit te sigurimit te tenderit dhe se AK do te kete ne konsideratc se ne kete situate pandemia nuk do ta refuzoje asnje tender per Moszgjatje te validitetit te tenderit si nje kerkese formale administrative.

Pretendimi Nr.2

Me kete pretendim e kemi kundershtuar vendimin per dhenien e kontrates grupit te OE fitues "Arbor Group & Euro Via" per shkak se pretendojme se tenderi i dorezuar nga ana e tyre eshte i papergjegjshem per shkak se nuk i ploteson Kerkesat mbi Mundesite Teknike dhe/ose Profesionale, ne kerkesen e speeifikuar me Nr.l (menagjeri i projektit -Inxhinier i ndertimtarise.drejtimi konstruktiv ose infrastrukture rrugore me se paku 5 vite pervoje pune) te pikes 9.1&9.2 te FTD-se se dosjes se tenderit. Faktet qe i kemi hasur gjate qasjes zyrtare ne dosjen e tenderit te OE fitues tregojne se AK nuk eshte permbajte nga favorizimi i OE ne fjale dhe nuk e ka respektuar parimin e drejtesise dhe trajtimit te barabartc gjate pcrzgjedhjcs se ketij ofertuesi duke e bcre vleresirnin nc kundershtim me nenin 59.4 te LPP-sc dhe nc kundershtim me kerkesat e percaktuara ne dosjen e tenderit i cili eshte dokument bazik themelor per zhvillimin e nje aktiviteti te prokurimit. Ne rastin konkret, konkretisht tenderi ne fjale i OE te përzgjedhur fitues nuk ka qene perputhshmeri me kerkesen per stafin profesional (menagjeri i projektit -Inxhiuier i ndertimtarise.drejtimi konstruktiv ose infrastrukture rrugore me se paku 5 vite pervoje pune) te pikes 9.1&9.2 te FTD-se se dosjes sc tenderit nga i cili varet ccuria, siguria, cilesia e realizimlt te projektit. Per ta plotesuar kete kerkese ne piken 9.2 te dosjes se tenderit eshte kerkuar deshmia dokumentare: " *J-CVe inxhinierit, diploma e noterizuar (noterizimi te prezantohet nga vete inxhinieri te noteri) kontrata e punes me ofertuesin (kopje e noterizuar, noterizimi te behet ne pretence te te dyja paleve), referenca per Menaxherin e Projektit. Ne rast se eshte angazhuar vetem per kete projekt, marreveshja te jete e nenshkruar ne pretence te noterit (vertetim i nenshkrimit)"* Parashtruesi duke vepruar ne baze kcrkeses per qasje zyrtare te aprovuar nga ana e AK-se, me date 06.05.2020 ka realizuar qasje zyrtare ne dosjen e OE fitues "Arbor Group" dhe dosjen e tenderit te dorezuar nga OE "Teuta -M" dhe ate ne dokumentaeionin sic jane konstatuar ne procesverbaline mbajtur nga perfaqesuesi i AK-se z. Xhevdet Zylfiu dhe i nenshkruar nga te dy palet. Nje nder dokumentet qe e kemi siguruar gjate qasjes zyrtare ne dosjen e OE "Arbor Group" i cili ka te beje me plotesimin tek Kerkesat mbi Mundesite Teknikc dhe/ose Profesionale, kerkesen e specifikuar me Nr.l (menagjeri i projektit -Inxhinier i ndertimtarise.drejtimi konstruktiv ose infrastrukture nugore me se paku 5 vite pervoje pune), eshte kopja e Kontrates te Punes per Pune dhe Detyra Speciflke e lidhur me date 06.11.2019 ne mes punedhcnesit "Arbor Group" Sh.p.k. me seli ne Kamenice dhe punemarresit Arsim Rapuca nga Gjilani me profesion Inxhinier i diplomuar i ndertimtarise. Objekt i Iidhjes se kesaj kontrate eshte kryerja e puneve dhe detyrave specifike nga punemarresi per punedhenesin nese shpallet fitues ne projektin: *"Rregullimi i shtratit dhe i zonave te degraduara te lumit Desivojce- Komuua e Kamenices, me nr. te prokurimit* KM53-19-7914-511. Pra ne rastin konkret OE fitues c ka caktuar per mcnagjer te projektit lidhur me lenden e kontrates ne fjale nga i cili varet ecuria, realizimi dhe cilesia e projektit, ne shumen e fituar 477,002.50€, z. Arsim Rapuca ing te ndertimtarise ne cilesine e menagjerit te projektit me kontrate tepunes PER PUNE DHE DETYRA SPECIFIKE (pune sekondare) e eila sipas ligjit te punes nuk mund te jete me e gjate se njeqindenjezet (120) dite brenda nje (1) viti, ndersa ne anen tjeter sipas nenit 5.2 te dosjes se tenderit afatet per fillimin dhe perfundimin e kontrates jane 24 muaj (12 muaj per nje vit). Prandaj me kete deshrni lidhur me ing nc fjale, OE "Arbor Group" Sh.p.k, nuk e ka plotësuar kriterin e kërkuar professional lidhur me kërkesën e vendosur ne nr.19(menaxheri I projektit- ongjinjer I ndertimtarise drejtimi konstruktiv ose infrostrukture rrugore se paku 5 vite pervojë pune të pikes 9.1&9.2 të DT dhe atë për arsyet si në vijim:

Ne baze te infonnatave publike te siguruara nga ueb faqja zyrtare e Kolegjit UBT, z. Arsim Rapuca me te cilin OE fitues ka lidhur kontratc te punes per mcnagjimin e projektit nc fjalc, eshtc i punesuar me punc tc rregullt me oral' te plote *"ULL TIME STAFF"* si profesor *(ne master lenden Urat dhe materialet ndërtimore)* dhe njekohesisht asistent *(bachelor ne lenden Urat ne specializim dhe lëndën Strukturat Inxhiuierike)*tek punedhenesi (primar) Kolegji UBT. Punesimi i tij nc UBT nga 03/2016 dcshmohet edhe nga vet CV e tij e cila eshte pjese e dosjes se tender te OE "Arbor Group". Bazuar ne aktet ligjore dhe nenligjore per arsimin e larte ne Republiken e Kosoves te nxjerr nga Ministria e Arsimit si dhe ne

aktet e brendshme (Rregullorja per organizimin e procesit mesimor) te nxjerr nga UBT, uuiversiteti organlzon studimet 11e pajtim me programer ekzistuese te studimit gjate vitit akademik i eili zgjate 12 muaj. Viti akademik filion me 1 tetor dhe mbaron me 30 shtator. Periudha aktive e studimeve (ligjeratat, ushtrimet, seminaret, kolokuiumet) eshte e ndare ne dy semestra.
Seminari dimëror që fillon me 1 tetor dhe mbaron me 15 janar. Semestri veror qe fillon me 16 shkurt dhe mbaron me 31 maj, Afati i provimeve (studimet bachelor dhe master) te cilat jane te percaktuar me kalendarin e pergjithshem te studimeve dhe perfshijne afatiu e dilllrit (janarit), prallveres (gershorit) dhe vjeshtes (shtatorit). Ne baze te nenit 10 te Ligjit te Punes percaktohet se Kontrata pel' nje detyre speclfike, nuk mund te jete me e gjate se njeqindenjezet (120) dite brenda nje (1) viti.
Po ashtu me kete dispozite ne paragrafin 9 te ligjit theksohet se *me Aktiu e Breudshem te Punedheuesit, tpercaktohet koha ne rastet kur me te punesuarin muud te themelohet marredheuia e puues ne kohe te caktuar dhe pune specifike, ne pajtim me kete ligj.*
Ne anen tjeter lidhur me lenden konkrete, AK-ja ne dosjen e tenderit, Nr. e nenit 5.2 ka parapare se afatet per fillimin dhe perfuudlmin e kontrates jane 24 muaj, Qe rrjedhimisht nenkupton se sipas normave ligjore te cekura ky aktivitet nuk eshte e mundslune te realizohet pennes kontrates per pune specifike e cila eshte e kufizuar ne 120 dite brenda vitit e ndersa afati per fillimin dhe perfundimin e puneve eshte i percaktuar te perfundohet per 24 muaj. Ne rastin konkret OE i rekomanduar per kontrate ka lidhur kontrate per pune speci fike me ing. Arsim Rapuca i cili eshte cakruar te jete menagjer i projektit nga i cili edhe va ret ecuria, cilesia e punimeve dhe materialeve si dhe periudha e ekzekutimit dhe permbushjes se kontrates. Pra OE ne fjale nuk e ka te punesuar me kontrate te rregullt dhe orar te plote nje ing te ndertimtarise per ta caktuar menagjer te projektit, Mirepo per ing te ndërtimtarisë i cili njekohesisht eshte menagjer i projektit dhe eshte pergjegjes per mbikqyrjen e kryerjes se puneve dhe per te gjitha hollesite e ka caktuar nje person i cili eshte i punesuar me kontrate te rregullt dhe orar te plote si profesor tek punedhenesi kryesor (primal") Kolegji UBT. E qe pertej se eshte e pamundur ligjerisht ne praktike eshte e pamundur qe te mbikqyret kryerja e puuimeve te projektit nga nje menagjer i projektit me kontrate per pune specifike i cili ka nje pune te rregullt me nje institucion tjeter, pasi qe ai ka obligime qe rrjedhin nga marredhenia e rregullt e punes dhe nuk mundet te jete prezent ne te njëjtën kohe ne dy vende te punes edhe per te dhene mesim si profesor e ne anen tjeter per te menagjuar projektin ue fjale nga i cili varet ne menyre direkte cilesia, siguria dhe realizimi i plote dhe i suksesshem i projektit sipas kushteve te kontrates. Nder detyrat dhe funksionet e menagjerit te projektit jane: a) *Te siguroje qe operatori ekonomik i pennbush te gjitha obliginiet e performances apo dergeses lie perputhje me termat dlie kuslitet e kontrates;* b) *Te siguroje se ka kontroll adekuat te kostove, cilesise, dhe kohes aty kit eshte e pershtatshme.*
Qe ne rastin konkret pertej pamundesise ligjore menagjeri i projektit i kontraktuar me kontrate per punc specifike nga ana e OE fittles edhe ne kontekst faktik nuk mundet qe t'i plotesoje keto funksione per realizimin dhe penl1busl~en e projektit ne fjale per faktill se i njejti eshte ne marredhenie te rregulHt punes "ULL TIME STAFF" si profesor (ne master ienden Urat dhe materiale ndertimore) dhe njekohesisht asistent (bachelor ne lenden Urat ne specializim dhe lenden Strukturat Inxhinierike) tek punedhenesi kryesor (primar) Kolegji UBT. Kontrata per nje detyre specifil{e, Iluk mund te jete me e gjate se njeqindenjezet (120) dite brenda nje (1) viti qe i bie l<ater (4)muaj. Andaj bazuar ne nje analize te thjeshte nga gjendja faktike duke llogaritur afatin ligjor te kontrates per pune specifike qe nuk mllnd te jete me e gjate se 120 dite brenda nje viti, dhe ne anen tjeter afatin per fillimin dhe perfundimin e kontrates siy eshte shenuar ne FTD te dosjes se tenderit 24 muaj, rezulton se OE te rekomanduar per kontrate per ta realizuar projektin permes menagjerit me kontrate per nje detyre specifike i nevojiten 5-6 vite. Andaj perkunder se parashtrucsi ka paraqitur fakte te besueshme dhe verifikueshme lidhur me punesimin e z. Arsim Rapuca si profesor (master) dhe asistent

(bachellor) ne Kolegjin UBI, AK-ja nuk ka shprehur fare gatishmeri dhe interesim qe te zbatoje dispoziten ligjore te nenit 72 te LPP-se me qellim t'i verifikoje dhe sqaroje keto informacione permes tenderuesit fitues apo direkt pcrrnes SH.M. "Mehmet Isai" dhe Administrates Tatimore,
Nga Kolegji UBT kishte qene e nevojshmc te kerkohesin infonnata me gjendjcn reale lidhur me marredhenien e punesimin te tij ne kolegj si dhe informata se a i eshte lejuar z. Arsim Rapuca e drejta e punes angazhimit ne aktivitetet jashte fakultetit per pune specifike pasi qe kjo cshte kerkese ligjorc me akte te brendshme te arsimit si dhc ne baze te nenit 10 paragrafi 9 te Ligjit te Punes Nr.03/L-212, ne baze te Aktin c Brendshem te Puncdhenesit, ku percaktohet koha ne rastet kur me te punesuarin mund te themelohet marredhcnia e punes ne kohe te caktuar dhe pune speciflke, në pajtim me kete ligj.
Ndersa nga A TK te kerkoheshin infounata ku do te sqarohej gjendja rcalc/e sakte lidhur me pasqyren mujore te tatimit ne burim (ËM) dhe institucionet e tjera te cilat i menaxhojne dhe administrojne skemat e obligueshme pensionale dhe skemat e tjera te obligucshme. Karshi fakteve te prezentuara konsiderojme se AK-ja e ka rrezikuar qellimin dhe lenden e prokurimit dhe ne anen tjeter nuk eshte siguruar per shfrytezimin e drejte fondeve publike per ta siguruar vleren per parane, per faktin se me vendimin e saj e ka mbajtur te drejtuar dhenien e kontrates te nje OE i cili karrshi AK-se nuk ka treguar besueshmeri dhe sinqeritet ekonomik, qe perrnbushjen e kapacitetit profesional lidhur me menagjerin e projektit (nuk e ka te punesuar me pune te rregullt dhe orar te plote staf profesional ing i ndertimtarise) por e ka vene ne lajthim/mashtrim AK me nje kontrate per pune specifike te nje ing i cili eshte i puncsuar me orar te plotc dhe pune te rregulIt ne nje institucion tjcter. Pra si rrjedhoje AK-ja me vctedije te p]ote ka rrezikuar shpenzimin e fondeve publike ne shumen 477,002.50€ duke ja konfirmuar dhenien e kontrates llje kompanic e ella ne kuader te saj nuk e ka te punesuar me kontrate te rregullt dhe orar te plote nje ing te ndertlmtarise per ta menagjuar projektin. Po ashtu ngrisim dyshimin se cshte fiktive dhe pcrmban informata mashtruese Referenca e leshuar nga OE "Arbor Group" Sh.p.k. per Arsim Rapuca nga permbajtja e te ciles thuhet se Arsim Rapuca ka qene menagjer i projektit me titul1: "Mirembajtja dhe rregullimi i hapesirave per gjelbrim" me nr. prokurimi KM-653-15-018-221 i realizuar ne periudhen kohore *10/2015* deri *10/2017* sipas kontrates te lidhur me AK- Komuna c Kamenices si dhe menagjer i projektit me titull: "Sherblmet e pastrimit te rrugcve, trotuareve dhe mirembajtja e varrezave te deslunoreve, lumit dhe parqeve ne Viti" me nr. prokurimi VI-657-17-008-221 i realizuar ne periudhen kohore *06/2017* deri *06/2018* sipas kontrates te lidhur me AK- Komuna e Vitise. Ne duke u bazuar ne ligjin per qasje publike ne baze te dhenave (kontrata e puncs, CV -ja, Diploma) qe i kel11i sigurllar nga qasja zyrtare tek AK kel11ipyetur ne AIK se OE "Arbor Group" a e ka paraqitur ne listen e pagave z. Arsim Rapuca ne periudhen *10/2015* deri *10/2017* dhe periudhen *06/2017 - 06/2018* dhe verbalisht kemi pranuar infonnata se i njejti gjate kesaj periudhe nuk ka punuar dhe nuk ju kane deklaruar e as paguar tatimi ne burim. Andaj i propozojme OSHP-se (ekspertit shqyrtues dhe panelit shqyrtues) qe te kerkojne informata zyrtare nga ATK ku do te sqarohcj gjendja reale e sakte lidhur me pasqyren mujore te tatimit ne burim (ËM) te deklaruar nga OE "Arbor Group" per periudhen *10/2015 - 10/2017* dhe periudhen *07/2017 - 06/2018* se a eshte i perfshire ne listen e pagave/deklarimit te tatimit ne burim z. Arsim Rapuca. Dhe pasi qe t'a verifikoni ketc informacion duke u bazuar ne fakte te verifikuara nga pcrgjigja e ATK-se, se tenderuesi ne fjale me dashje ne dosjen e tenderit ka paraqitur nje dokument me infonnacione permbajtesisht te gabueshme ose mashtruese, kerkojme nga OSHP qe ndaj tij te iuicohet procedura e sanksionimit ligjor sic parashihet me ligjet ne fuqi. Andaj duke II bazuar ne faktet e prezentuara si me larte kemi ardhur ne pcrfuudim se OE fitues "Arbor Group" nuk e ka plotesuar kerkesen e AK-se te percaktuar ne piken 9,1&9,2 te FTD-se lidhur me kriterin e kerkuar te kapacitetit profesional ne kerkesen nr.1 *(menagjeri i projektit -inxliinier i udertimtatise.drejtimi konstruktiv ose infrastructure rrugore me se paku 5 vite pervoje pllle)* nga i cili varet drejtimi, cilesia.siguria dhe realizimi i plote dhe i suksesshem i projektit sipas kushteve te kontratës. E qe per rrjedhoje procedura e vleresimit dhc dhcnie e kontrates OE "Arbor Group" Sh.p.k, nga Kamenica, eshte bere nc kundershtim te plotc me nenin 59.4, nenin 69

paragrafi 6 dhe uenin 60 par. 1,1, te LPP-se kriterin kryesor per dhenien e kontrates qe ka qene teuderi i pergjegjshem me cmim me te ulet, Po ashtu jane shkelur parimet bazike/kryesore te procedures se vleresimit nga neni 41,3 i RrUOPP dhe duke vepruar.

Pretendimi Nr. 3

Ashtu sic pretenduar ne kerkesen per rishqyrtim, gjate realizimit te qasjes zyrtare ne dosjen dosjen e tenderit te dorezuar nga OE "Teuta -M" kemi ardhur deri te faktet dhe argumentet se OE ne fjale uuk e lea plotesuar krlterlu e kerkuar profesioual lldhur me kerkesen nr.1 *(menagjeri i projektit -inxhinier i ndertimtarise.drejtimi konstruktiv ose infrastrukture rrttgore me se paku 5 vite pervoje pUl/e)* te pikes 9, 1&9,2 te closjes te tenderit. Nga dokumentct qe i kemi pare me sy gjatc qasjes zyrtare ne prezcncen e zyrtarit qe ka mbikqyrur qasjen mirepo te cilat nuk na jane dhene kopje me arsyetimin se kerkeses se OE ne fjale per sekret afarist, kemi verejtur se OE "Teuta -M" per ta plotesuar kerkesen Nr.l per menagjer te projektit ka paraqitur ing. i diplomuar me l974 Sali Halili nga Gjilani. Prandaj me kete deshmi lidhur me ing ne fjale, OE "Teuta M" Sh.p.k. nuk e ka plotesuar kriterin e kerkuar profesional lidhur me kerkesen e vendosur me nr.l *(menagjeri i projektit -inxhinier i ndertimtarise.drejtimi konstruktiv ose infrastrukture rrugore me se paku 5 vite pervoje puney* te pikes 9,1&9,2 te dosjes te tenderit, dhe ate per arsyet si ne vijim:

Ne baze te infonnatave publike te siguruara nga ueb faqja zyrtare e Komunes se Gjilanit, vegeza e~arsimi.gjilal1i.im z, Sali Halili te cilin OE fitues e ka paraqitur menagjer per ta menagjuar projektin ne fjae, eshte i punesuar me kontrate te rregullt, oral' te plote si profesor tek punedhenesi kryesor (primar) Shkolla e Mesme "Mehmet Isai" dhe jep meslm ne Ienden Praktike 1, CAD, vizatimi teknik dhe aplikimi me kompjuter.

Ne rastin konkret OE ne fjale ka lidhur kontrate per pune specifike me ing. Sali Halili i eili eshte caktuar te jete menagjer i projektit nga i eili edhe varet ecuria, cilesia e punimeve dhe materialeve si dhe pcriudha e ekzekutimit dhe permbushjes se kontrates, Pra OE ne fjalc nuk e ka te punesuar me kontrate te rregullt dhe oral' te plote nje ing te udertimtarise per ta cakruar menagjer te projektit. Mirepo per ing te ndertimtarise i cili njekohesisht eshte rnenagjer i projektit dhe eshte pergjegjes per mbikqyrjen e kryerjes se puncve dhe per te gjitha hollesite e ka eaktuar uje person i eili cshte i punesuar me kontrate te rregullt dhe oral' te plote si profesor tek punedhenesi kryesor (primm') Shkolla e Mesme "Mehmet Isai" ne Gjilan. E qe pertej se eshte e pamundur ligjerisht ne praktike eshte e pamundur qe te mbikqyret kryerja e punimeve te projektit nga nje menagjer i projektit me kontrate per punc specifike i cili ka nje pune te rregullt me nje institueion tjetcr, pasi qe ai ka obligime qe njedhin nga marredhenia e rregul1t e punes dhe nuk mundet te jete prezent ne te njejten kohe ne dy vende te punes edhe per te dhene mesim si profesor e ne anen tjeter per te menagjuar projektin ne fjale nga i cili varet ne menyre direkte cilesia.siguria dhe realizimi i plote dhe i suksesshem i projcktit sipas kushteve te kontrates. Andaj perkunder se parashtruesi ka paraqitur fakte te besueshme dhe verifikueshme \idhur me punesimin e z. Sali Halili si profesor ne shkollen e mesme "Mehmet Isai", AK-ja nuk ka shprehur fare gatishmeri dhc interesim qe te zbatojc dispoziten ligjore te nenit 72 te LPP-se me qellim t'i verifikoje dhc sqaroje keto infonnaeione permes tenderuesit fitues apo direkt permes SH.M. "Mehmet Isai" dhe Administrates Tatimore. Nga shkolla e mesme "Mehmet Isai" apo Drejtoria e Arsimit ne Komunen e Gjilanit kishte qene e nevojshme te kerkohcsin informata me gjendjen reale lidhur me marredhenien e punesimin te tij ne shkolle si dhe informata se a i eshte lejuar z. Sali Halili e drejta e punes /angazhimit neaktivitetet jashteshkollore per pune specifike pasi qe kjo eshte kerkese ligjore me akte te brendshme te arsimit si dhe ne baze te nenit 10 paragrafi 9 te Ligjit te Punes Nr.03/L-212, ne baze te Aktin e Brendshem te Punedhenesit, 1m percaktohct koha ne rastet 1mI' me te punesuarin mund te themelohet maI'I'edhenia e puncs ne kohe te caktual' dhe pune specifikc, nc pajtim me kete ligj. Ndersa nga ATK te kerkoheshin informata ku do te sqarohej gjendja reale/e sakte lidhur me pasqyren lllujore te tatimit ne burim (ËM) dhe institueionet e tjera te eilat i menaxhojne dhe admillistrojne skemat e obligueshme pensionale dhe skemat e tjera te obligueshme.

Andaj bazuar ne faktet e konstatuara me larte kOllsiderojme se OE "Teuta -M" nuk i ka plotesuar ne teresi kushtet e percakhlara ne piken 9.1 &9.2 te FTD-se lidhur me kri terin e kerkuar te kapacitetit profesional ne kerkesen nr,1 *(Menagjeri i projektit -inxhinjer i ndertimtarise, drejtimi konstruktiv ose infrostrukture rrugore, se paku 5 vite pervoje pune) nga* cili varet drejtimi, cilesia,siguria dhe realizimi i plote dhe i suksesshem i projektit sipas kushteve te kontrates. Ndersa ne anen tjeter AK-ja gjate procedures se vleresirnit dhe procedures se nxjerrjes se vendi mit me te cilin e ka kundershtuar si tc pabazuar kerkesen e OE ankues, duke mos shprehur gatidhmeri per t'i korrigjuar shkeljet e bera, ka vepruar ne kundershtim me pari met bazike/kryesore te procedures se vleresimit nga neni 41.3 i RrUOPP dhe duke vepruar ne kundershtim te plote me nenin 59.4, nenin 69 paragrafi 6 dhe nenin 60 par.l.l. dhe nenin 72 te LPP.

Pretendimi nr.4

Konsiderojme se me rastiu e qasjes zyrtare ne dosjen e OE "Teuta -M" kufizimi i te drejtes per te marre ne posedim kopjet e deshmive lidhur me menagjerin e projektit nuk eshte bere ne pajtim me nenin 10 par. 5 lidhur me nenin 11 te LPP-se dhe bazat e lejueslune per refuzimin/kufizimin e qasjes ne dokumente publike/zyrtare. Kufizimi i te drejtes per qasjc ne clokumente publike behet vetem ne rastet e kufizuara dhe specifike te percaktuara me legjislacionin ne fuqi. Gjate qasjcs ne nuk kemi verejtur se AK c ka klasifikuar nje element tc informates si iuformate sckrete afariste sipas pargarfit 3 te nenit 11 te LPP-se dhe nuk e ka pergaditur verzionin e pastruar/fshire informatat te tilla si sekret afarist te ketyre dokumente lidhur me deshmite per menagjer te projektit dhe te njejtin nuk e ka larguar nga materiali ne te cilen palet e intercsuara kane qasjc sipas paragrafit 3 te nenit 10 te LPP-se. Perkunder se AK eshte thirrur ne informata sekrete afariste sipas kerkeses se OE ne fjale, keto dokumente kane qene te bashkeugjitura ne dosje dhe te qasshme per tu pare me sy 9jo te fshira infonnatat e tilla sekrete sic eshte thirrur AK). Po ashtu rcfuzimi i rnarrjes ne posedim te ketyre dokumentcve na u eshte bcre pa pasur nje arsye te justifikueshme dhe nje test te demit dhe interesit publik per te percaktuar nese demi i shkakruar interesit te mbrojtur mbisundon interesin e publikut/pales se interesuar per qasje ne ate dokument publik. Nuk ka pasur asnjc arsye te bindshme se qasja ne ate dokumentc do te rezultonte me demtim te drejtes per privatesi dhe demtim material te interesave legjitime komerciale te OE ne fjale.

Pretendimi nr.5

Konsiderojme se me vendimin e kundershtuar, AK ka vepruar ue kundershtim me parimin e barazisc dhe mosdiskriminimit per arsye sc nuk i ka trajtuar te gjithe OE ne menyre te barabarte dhe pa diskriminim. Dhenien e kontrates e ka bere tek OE i papergjegjshem ne kundershtim te plote me 7 parimet kryesore te procesures se vleresimit te lidhura ne zbatim tc nenit 59.4 dhe 60.1.1. te LPP-se.

Me vendimin ne fuqi te drejtuar ne dhenien e kontrates te OE i parapelqyer "Arbor Group" e cila eshte me seli nga Kamenica, AK-ja nuk eshte permbajtur nga favorizimi territorial dhe material karrshi ketij OE dhe ne anen tjeter duke diskriminuar OE tjere pjesemarres nuk e ka rcspektuar drejtesine dhe trajtimin e barabarte ne mes OE. Po ashtu me vendimin e kundershtuar AK nuk ka vepruar ne perputhje me qellimin e prokurimit ne baza faktikc dhe ligjore qe tc siguroje menyren me efikase dhe ekonomike te shfrytezimit te fondeve pub like duke pasur ne konsiderate qellimin dhe lenden e prokurimit ne perputhje me kerkesat procedurale dhe qenesore te ketij ligji. Prandaj duke vepruar ne kundershtim me llenin 59 dhe 60 te LPP-se njekohesisht ka vepruar edhe lie kundershtim me frymen e nenit 1 dhe nenit 7 i LPP-se per arsyet e sipertheksuara.

Autoriteti Kontraktucs me cit. 08.05.2020 ka nxjerrur vendimin Nr.9247 me ane te cilit nuk jane dhene arsye rnbi provat e paraqitura dhe faktet vendimtare qe e kane kushtezuar marrjeu e vendimit te kundershtuar, e ka refuzuar si te pabazuar kerkesen per rishqyrtim dhe e ka lene ne fuqi vendi min e dt. 29.04.2020 per dhenien e kontrates OE "Arbor Group". Bazuar ne arsyetimin e vendimit Nr.9247 me ane te cilit AK-ja e ka refuzuar si te pabazuar kerkesen per rishqyrtim dhe e ka lene ne fuqi vendimin

edt. 29.04.2020 per dhenien e kontrates OE "Arbor Group", verhet se AK-ja pretendimet ankimore nuk i ka vleresuar ne meuyre te drejte dhe te ligjshme mirepo ne menyren qe favorizohet OE i rekomanduar per kontrate dhe diskriminohen ne dem OE tjere pjesemarres, Arsyetimi i vendimit nuk perfshin shpjegimin e bazes ligjore dhe shpjegimin faktik per arsyet per refuzimin e preetendimeve ankimorc.

Me kcte vendim AK-ja nuk ka pasur parasysh menjanimin e shkeljeve ligjore dhe zgjidhjen e drejte, te ligjshme dhe efektive te leudes, Pra sipas ketij vendimi qe i paraprine vendimi paraprak i cit. 29.04.2020 per dhenien e kontrates OE "Arbor Group", *AK pajtohet qe te rrezikoje shfrytezimin e perdorintit ne menyre te padrejte te fondeve publike duke ia koufinuuar dhenien e koutrates nje OE i cili per meuagjer Ie projektit uga i cili varet sigurla, cilesia, performanca dlte realizimi i projektit, e ka paraqitur Ilje staf/ing me kontrate per pune specifike/te kufizuar z, Arsim Rapuca i cili eshti: i puuesuar me pune Ie rregullt me orar te plote "FULL TIME STAFF" si profesor (ne master lenden Urat dhe materiale ndertlmore) dlte ujekohesisht asistent (bachelor ne lenden Urat ne specializim dlte lenden Strukturat Inxhinierike) tek punedhenesi kryesor (printar) Kolegji UBT. Si rrjedhoje drejtimit te koutrates tek uje OE i parapelqyer AK ka rreziku shpetizimin e fondeve publike ne shutnen 477,002.50€ duke ja dhene kontraten OE ne fjale e cila lie kuader Ie sa] Ill1k e ka te punesuar me koutrate te rregullt dlie orar te plate nje ing te udertimtarise per ta menagjuar projektin. Ky eshte nje absurd i llojit te vet se si AK-ja me vetedije te plote i eliminon te gjithe OE tjere te pergjegjshen: e ne anen tjeter rrezikon projektin dhe mjetet te lartesine e shumes se lartecekur duke hyre marredhenie koutraktuale me kete OE qe nuk siguron besueshmeri dhe siuqeritet afarist i cili merr guximiu te ve ne lajthim/mashtrim AK-ne me nje kontrate per pune specifike per poziten kyqe menagjer i projektit nga i cili varet ecuria,ciliisia dhe siguria e realizimil te projektit dhe permbushjes se kontrates.*

Sa i perket arsyetimit te AK-se ne piken 2 ku thuhet se nuk munden te kerkojne sqarime shtese per llje kontrate qe nuk ka hyre ne fllqi duke aluduar ne kontratell per pune specitike te lidhur ne mes z. Arsim Rapuca dhe OE "Arbor Group" ku objekt i saj eshte caktimi menagjer i projektit i te parit lidhur me aktivitetin ne fjale, ky arsyetim eshte abstrakt, i pa1 1ljaftueshem, kunderthenes dhe i paqendrueshem ne kontekst te bazes ligjore. E para ne rastin konkret eshte themeluar nje marredhenie e punes duke liclhur kontrate pune per nje detyre specitike me karakter formal midis puncdhenesit dhe punemarresit.

Kjo kontrate ka hy ne fuqi me rastin e nenshkrinut nga palet. Fakt tjeter se kontrata ka hy ne fuqi dhe ka proclhuar efektin e pare juridik deshmohet penlles Vendimit te dt. 06.11.2019 per Emerimin e Menagjerit te Projektit Arsim Rapllca, inxhinier i diplomuar i ndertimtarise per t'i uclhehcqur punimet ne emer te OE "Arbor Group" sipas projektit ne tendcrin me titull: Rrcgullimi i shtratit dhe zonave te clegraduara te lumit Desivojce -Komuna e Kamenices" me nr. prokurimi KM-653-19-7914-5-1-1. Ketij vendimi i ka parapri kontrata per pune specifike e lidhur ne mes OE "Arbor Group" (punedhenes) dhe Arsim Rapuca (punemarrres) objekt i se ciles eshte caktimi/emerimi menagjer i projektit i te parit lidhur me aktivitetin ne fjale. Se dyti, autoritcti kontraktues me qellim qe te behct egzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tenderevc apo gjate rivlercsimit tc lyre mundet tc kerkoje me shkrim nga operatoret ekonomikltenderuesit qe te dorezojne, plotesojne, sqarojne apo kompletojne informacionin apo dokumentacionin e cluhur brenda nje afati te caktuar ne perputhje me pari met e trajtimit te barabarte dhe transparences per clokumentat egzistcnca e te cilave cshte e fiksuar para skadimit te afatit per dorczimin c tendereve.

Mirepo arsyeja pse nuk eshte injoruar dhe marre ne konsiderate neni 59.2 dhe neni 72 i LPP-sc dhe nuk jane kerkuar sqarime dhe informacione shtesc nga OE fitues "Arbor Group" eshte per faktin se AK-ja nuk ka mundur apo dashur te permbahet nga favorizimi direkt, territorial dhe material qe kontrata te mbetet e drejtuar tek OE i parapelqyer "Arbor Group".

Andaj bazuar ne te lartecekurat i propozojme OSHP qc te **APROVONI** ne tersi ankesen si te bazuar dhe merrni Venclim me te cilin **Anulohet** Njoftim Vendimi per Dhenieu e Kontrates OE "Arbor Group" sh.p.k., dhe lenden ta ktheni ne Rlvleresim, dhe te Urdherohet AK-ja gjate rivleresimit te ndermerr veprime korrigjucse dhe tc vendose ne baze te gjeturave nga provat c prezentuara, t'i perrnbahet ne dctaje te gjitha dispozitavc te LPP-se dhe dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate. Vleresimi i ofertave dhe dhenia e kontrates te behet ne pajtim rigoroz me vleresimin e kryer sipas 7 parimeve te nenit 43 te RrUOPP dhe nenit 59.4 dhc 60.1.1 tc LPP-se.

KRITERET PËR VLERËSIM

Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.

Arsyet e eleminimit te OE ankues "Area" eshte per shkak se nuk është permbushir kërkesa e DT per 1.000.000,00 € projekte te kryera ne periudhën e shkuar 3 vjeqare,

Arsyet e eleminimit te OE ankues "Rexha" me te tjerët eshte per shkak se nuk ka bere vazhdimin e validitetit dhe sigurimit te oferte sipas kerkese se datës 21.14.2020 nga AK.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Komisioni vlerësues konstaton se AK se dy OE ankues janë te pa përgjegjshëm per arsyet qe i theksuam me larte.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka marre eksperti shqyrtues informacion shtese.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

OE ankues **"Area"** është pale e interesit ne këtë aktivitet te prokurimit.

OE ankues **"Rexha & KONTI-Betoni & Deshishku AG" nuk** është pale e interesit ne këtë aktivitet te prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

Ka pasur vendim te me hershem te OSHP-se. Ka pasur vendim te OSHP-se nr.971/19.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

Nuk kemi devijim nga praktikat e me hershme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Area" dhe "Rexha & KONTI-Betoni & Deshishku AG"-

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues **"Area"** se AK nuk ka respektuar afatet ligjore pika 31dhe 31.4 te RRUOPP sepse ka mbajtur në sirtar të vet lendën e dosjes së tenderit të cilat kanë qenë pa validitet dhe pa sigurim të tenderit, duke pasur parasyshë se nga data e hapjes së tenderit e deri në kërkesën e AK-së 21.04.2020 kur ka bërë kërkesën për OE konkurrues për vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të tenderit, kanë kaluar plotë 47 ditë që dokumentacioni dhe çmimet e ofruara nga OE konkurrues kanë qenë të pa afatshme, duke përfshirë edhe kompaninë e shpallur fitues, OE "Arbor Group & Euro via", eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti kontraktues nuk ka bërë vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të ofertave sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin sekondar për prokurim publik. Neni 31.4 i RRUOPP thotë:

*'Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe **duhet të kërkohet para datës së skadimit** (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit.)*

Pra sipas kësaj dispozitë çartë përcaktohet se para skadimit të validitetit nga AK duhet ti dërgohet tenderuesve kërkesa për vazhdim të validitetit. Në rastin konkret AK nuk ka vepruar drejtë sepse për një kohë të gjatë ofertat e këtij tenderi kanë qenë të skaduar. Nuk mundt të këtë pauza (ndërpreje) të afatit të validitetit të tenderit gjatë fazës së vlerësimit të tenderit. Aryetimet e AK-së se është pritur miratimi i buxhetit, nuk është justifikim. Projekti duhet të inicohet dhe te planifikohet me kohë dhe në përputhje edhe me rregullat financiare dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë siç parashihet ne nenin 22 të LPP-së.

Ky pretendim i OE ankues "Area" është kontradiktor me kërkesën përfundimtare në ankesë për Rivlerësim të këtij aktiviteti të prokurimit. Nese ka shkelje nga AK gjatë procedurës siç është konstatuar në këtë rast nga OE ankes që ofertat nuk kanë pasur validitet 47 ditë, kjo shkelje nuk mundet të riparohet me rivlerësim të ofertave. Si do që të jetë shkelja ka ndodhur nga AK në këtë rast. Prandaj pretendimi ankimor është i **bazuar**.

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se sipas autoriteti kontraktues nuk janë plotësuar kërkesat e FDT pika 9.1&9.2 pika 2. Lista e Projekteve, kontratat e përfunduara dhe kontratat që janë në ekzekutim (duke mos përfillur nenin 7 par 1,2 dhe 4 i LPP-së, lidhur me parimet bazike nga nenin 4.4 i RRUOPP. Pra AK nuk i pranon certifikatat e punëve që janë ekzekutuar dhe të pranuara nga institucionet e Kosovës, në këtë rast nga MAP-i si donator për projektin **që është në ekzekutim** me titullin **"Ndërtimi i shkollës fillore në Pozharan"** vlera e punimeve të pranuara është 636.304,05 posedon çertifikatën e pranimit të punëve në bazë të kërkesave të kontratës saksisht neni 24 përfundimet dhe certifikatat e pranimit të punëve dhe nenit 25 llogaritja përfundimtare. Pjesa e II e kontratës kushtet e përgjithshme, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Lidhur me këtë pretendim ankimor në vendimin e OSHP-së nr.971/19 është theksuar se AK duhet të kërkoj nga OE ankues në këtë rast "Area" sqarime shtesë në bazë të nenit 59 dhe 72 të LPP-së lidhur me listën e projekteve të realizuar për plotësim të kërkeës 9.1&9.2 pika 2 të FDT-së. Gajtë rivlerësimit të ofertave AK në zbatim të vendimit të OSHP-së ka kërkuar sqarime shtesë nga OE "Area" për listën e projekteve të realizuara.

OE ankues në përgjieje të AK-së për sqarime, ka ndryshuar listën fillestare të dorzuar me ofertë duke reduktuar numrin e projekteve nga 15 në 11. Projekti i OE ankues që nuk është pranuar nga AK **"Ndërtimi i shkollës fillore në Pozharan"** është projekt i **pa përfunduar**.

Vlera e këtij projekti sipas kontratës që OE ka të ngarkuar në platformën elektronike me ofertë është 1.397.508,33 € dhe një Ankes kontratë e lidhur me datë 04.11.2019 me MAP në vlerë prej 90.466,00 €. OE "Area" me ofetë ka dorzuar një "Çertifikatë të kompletimit të Punimeve-XIII".

Kjo çertifikatë është lëshuar nga Menaxheri i Kontratës për këtë projekt nga MAP-i për kryerje e pagesë së situacionit trembdhjetë (XIII) por jo çertifikatë e pranimit përfundimtarë të punimeve të realizuara për këtë projekt. Këresa e DT ka qenë "*Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve në lëminë e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare deri në njoftimin për kontratë*".Prandaj ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

OE ankues "Rexha & KONTI-Betoni & Deshishku AG"
Përgjigje në Pretendimin nr.1
Lidhur me pretendimin e OE ankues se arsyetimi i autoriteti kontraktues per eliminimin e tij me arsyetimin se gjoja nuk kemi vazhduar validitetin dhe sigurimin e tenderit. Eshte e vertete se grupi i OE ankues nuk e ka vazhduar validitetin e sigurimit te tenderit sic eshte kerkuar me shkrim nga AK me shkakun e situates se krijuar nga pandemia COVIT -19 ku procesi i vleresimit nuk ka mundur qe te finalizohet brenda afatit te periudhes se validitetit te tenderëve, eskperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti kontraktues ju ka dërguar kërkesë të gjithë tenderuesve me datën 21.04.2020 për vazhdimin e validitetit të ofertës. Tani edhe vetë OE ankues e pranon se nuk e ka bërë vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të ofertës sipas kërkesës së AK-së.

Neni 35.5 i RRUOPP thotë "*Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre*". Sipas kësaj dispozite AK ka të drejtë të kërkoj zgjatje të validitetit të ofertave. Mirëpo neni 35.6 i RRUOPP thotë "*Është e hapur për secilin OE të vendosë nëse dëshiron të përtërijë validitetin e tenderit apo jo.* ***OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si "të papërgjegjshëm"*** *dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre*".

Sipas kësaj dispozite autoriteti kontraktues ka vepruar drejtë kur e ka eleminuar OE ankues në fjalë sepse OE ankues nuk e ka vayhduar validitetin e ofertes. Mendimi i OE ankues se ka qenë stuatë e Pandemise dhe nuk ka mundur të bëjë vazhdimin e validitetit nuk është justifikim sepse në rrethana të njëjta kanë qenë edhe operatoret e tjerë ekonomik që ju kanë përgjigjur kërkesës së AK dhe kanë bërë vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të ofertës. Te nejten gjë ka mundur të bëjë edhe OE ankues në fjalë. Prandaj ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

Përgjigje në Pretendimin nr.2, 3, 4 dhe 5
Lidhur me pretendimin e dytë dhe tretë te OE amkues se OE i rekomanduar për kontratë dhe OE "Teuta nuk e kanë plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit në piken 9.1&9.2 te FTD-se që ka të bëjë me menaxherin e projektit sepse këto kompani ka prezentuar për menaxher të projektit z.Arsim Rapuca respektivisht z. Salih Halili të cilët janë të angazhuar në punë primare në një institucion tjetër dhe të njëjtit nuk mundet të jenë të rregulltë si menaxher të projektit në kontratën eventuale me autoritetin kontraktues sepse kjo është në kundërshtim me

ligjin e punës. Gjithashtu pretendimi i katër i OE ankues se AK nuk ka respektuar edhe nenin 10 dhe 11 të LPP-së për kufizimin në çasjen e dokumenteve të OE "Teuta" dhe pretendimi i pestë se me këtë rast është shkelur nga AK parimi i barazisë sipas nenit 7 të LPP-së. eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Sipas kërkesës së AK të dhënë në dosjen e tenderit, OE i rekomanduar për kontratë dhe OE "Teuta" kanë ofruar kontratën e noterizuar për menaxher të projektit me inxhinjerin z.Arsim Rapuca respektivisht me z. Salih Halili të cilt kanë kualifikim përkatës dhe të njëjtit e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Nëse OE i rekomanduar për kontratë apo OE "Teuta" do të lidhin kontratën me AK, atëherë është çështje e z.Rapuca dhe z. Halili mënyra e angazhimit në projekt si punë primare apo në punën tjetër që kanë ata me institucione të tjera.
E rëndësishme për AK është që OE në fjlaë kanë ofruar kontratën me z. Rapuca dhe z. Halili sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Pra nuk qëndrojnë keto dy pretendime.
Sa i përket pretendimit të katër të OE ankues se nuk i është dhënë çasja e mjaftueshme dhe nuk është bërë nga AK klasifikimi i dokumenteve të OE "Teuta" mendimi jonë është se OE ankues i ka marrë dokumentet e nevojshme gjatë çasjes në ofertën e OE "Teuta". AK i ka dhënë hapësirën e nevojshme dhe kjo konfirmohet edhe me të dhënat që OE ankues i ka paraqitur në ankesë për ofertën ë OE "Teuta". Pra nga AK janë zbatuar dispozitat e nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Po ashtu nuk ka pasur diskriminim të asnjë operatori ekonomik siç e theksohet në pretendimin e pestë të OE ankues për shkelje të nenit 7 të LPP-së. Këto nuk qëndrojnë. Prandaj marrë në përgjithësi këto pretendime ankimore janë të **pa bazuar**.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Gjatë fazës së zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit, pas pranimit vendimit të OSHP-së nr. 971/19 të datës 5 shkurt 2020 nga autoriteti kontratues e deri me datën 21 prill 2020 të gjitha ofertat në këtë aktvitet të prokurimit kanë qenë të **sakduara (pa validitet)**. Një ndërprerje e validitetit të ofertave për një kohë kaq të gjatë është në kundërshtim me nenin 31.4 i RRUOPP që rrjedhimisht është shkelej e nenit 57 të LPP-së sepse vazhdimi i validitetit duhet të kërkohet nga AK para datës së skadimit të tyre, e jo pas siç ka vepruar AK.

OE ankues "Area" nuk i ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për realizimin e kontratave të kërkuara dhe është eleminuar me të drjetë nga ana e AK-së. Ndërsa konzorciumi "Rexha" me të tjerët është eelminuar me të drejtë sepse nuk ka bërë vazhdimin e validitetit të ofertave sipas kërkesës së AK-së dhe njëherit mendojmë se nuk është palë e interesit sipas nenit 4.1.26 sepse nuk e ka vazhduar validitetin e ofertë dhe po ashtu ka operatorë të tjerë të përgjegjshëm me çmim më të ulët se oferta e tijë.

Si përfundim i shqyrtimit të kësaj lënde, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **"Area"** të **Aprovohet pjesërisht** ndërsa oferta e konzorciumit **"Rexha"** me të tjerët të **refuzohet** si e pa bazuar. Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që aktivitetin e prokurimit **"Rregullimi i shtratit dhe zonave të degraduara të lumit Desivojcë-Komuna e Kamenicës"** me nr. prok. KM653-19-7914-5-1-1 ta **Ritenderoj** për shkak të mos vazhdimit të validitetit të ofertave me kohë sipas dispozitave të nenin 31.4 i RRUOPP.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Komuna e Kamenicës
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - "Area" SH.P.K"
- OE ankues - "Rexha & KONTI-Betoni & Deshishku AG"